



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

	REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E MITROVICES-OPSTINA MITROVICA	
Shifra e dokumentit	07-052/d-0037995/22	
Data e miratimit	27-04-2022	
Qytetet	Mitrovicë - Mitrovica	

# RAPORT PUNE

(Janar - Dhjetor 2021)

**Mitrovicë**

Drejtoria Komunale e Arsimit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, duke u bazuar në objektivat e hartuara sipas planit dinamik të punës dhe Planit Komunal për Zhvillimin e Arsimit 2018-2022, ka realizuar një varg punësh dhe aktiviteteve të cilat po i pasqyrojmë si në vijim:

- Përcjellja sistematike e gjendjes me pandemi në shkolla dhe koordinimi me IKShP-në, Task Forcën Komunale dhe Task Forcat e Shkollave;
- Dërgimi i raporteve në baza ditore në SIA-MAShTI për rastet me nxënës dhe personel arsimor të infektuar dhe për skenarët e organizimit të mësimit në kohë pandemie;
- Vizita monitoruese në institucione edukativo-arsimore për të parë zbatimin e masave antiCovid dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor;
- Analiza e raporteve të rregullta javore të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me përfaqësuesit e iniciatives së të rinjëve “Rini pa bullizëm” për të shyrtuar realizimin e projektit të mbështetur nga USAID;
- Zhvillimi i aktiviteteve për 1 Qershorin-Ditën e Fëmijëve në koordinim me asamblenë komunale të fëmijëve;
- Vizitë me 200 nxënës në kazermën e FSK-së, me datën 1 Qershor-Ditën e Fëmijëve;
- Nënshkrimi i marrëveshjes me Terre Des Hommes për dy qendrat mësimore me bazë në shkollë për organizimin e mësimit plotësues;
- Mbajtja e takimeve të rregullta mujore me drejtorë shkollash;
- Vizita të shpeshta në të gjitha institucionet arsimore;
- Monitorimi, kontrolli dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e rrjedhës së procesit edukativo arsimor;
- Koordinimi i vazhduar i trajnimeve për ngritje profesionale të mësimitdhënësve;
- Realizimi i trajnimeve për zbatimin e kurrikulës së re për të gjithë mësimitdhënësit të cilët do ta zbatojnë kurrikulën për herë të parë gjatë vitit 2021/22;

- Është organizuar dhe mbajtur Testi i Arritshmërisë 2021 sipas kërkesave nga MASHTI;
- Është mbajtur pilotimi i Testit PIRLS 2021;
- Është organizuar dhe mbajtur Testi Shtetëror i Maturës 2021 me një mbarëvajtje shumë të mirë;
- Është koordinuar regjistrimi i nxënësve në klasën parafillore dhe në klasën e parë;
- Është bërë regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme të larta për të dy afatet;
- Është bërë regjistrimi i të gjitha të dhënave të personelit arsimor, mësimdhënësve dhe nxënësve në databazën e Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA);
- Janë mbajtur takime me koordinator të cilësisë;
- Janë themeluar Aktivitetet Profesionale Komunale;
- Është rifunksionalizuar Ekipi Komunal për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta dhe Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit;
- Është bërë vlerësimi i performancës së drejtorit të SHMLE;
- Është duke u monitoruar zbatimi i Planit Komunal të Arsimit 2018-2022;
- Është koordinuar realizimi i praktikës profesionale të studentëve të drejtimeve arsimore në shkolla;
- Është siguruar transporti për nxënës;
- Janë zbatuar grantet për Qendrat e Kujdesit dhe Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme;
- Janë mbajtur shumë takime me donatorë, partnerë dhe OJQ të ndryshme;
- Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me donatorë, partnerë zhvillimor dhe organizata;
- Sipas nevojave të shkollave, DKA ka bërë rregullimet e nevojshme infrastrukturore;
- Janë gëllqerosur të gjitha ato shkolla që kanë pasur nevojë të gëllqerosen, si; Avni Shabani, Bislim Hajdari, Ismail Qemali, Mehë Uka, Xhevat Jusufi, Shemsi Ahmeti, etj.
- Të gjitha shkollat kanë bërë pastrime gjenerale gjatë kohës së pushimit veror dhe kanë realizuar renovime të vogla, të nevojshme;

- Rregullimi i pjesëve përcjellëse të kaldasë në IP;
- Furnizimi me inventar shkollor në disa shkolla;
- Ka filluar mësimi në objektin e ri të shkollës “Harun Beka” në Gushac;
- DKA bënë furnizimin me lëndë djegëse (dru, pelet dhe naftë) për të gjitha institucionet arsimore, duke përfshirë shkollat amë dhe paralelet e ndara.

Drejtoria Komunale e Arshit

The image shows a blue circular official stamp on the left, partially overlapping a handwritten signature in blue ink on the right. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top, "DREJTORIA KOMUNALE E ARSHIT" in the center, and "REPUBLICA OF KOSOVO" at the bottom. The signature is written in a cursive style over the stamp.